

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr 1, Tiranë

PROGRAMI
I KURSIT TË VEÇANTË

“Riparues Elektronik për Kompjuter”

Kodi: REK-2022

Miratoi:

DREJTOR

.....

Tiranë, 2022

PROGRAMI I KURSIT TË VECANTË

“Riparues Elektronik për Kompjuter ”

(REK-2022)

I. Profili Profesional i riparues elektronik për kompjuter

a) Karakteristikat e riparuesit elektronik për kompjuter.

Riparues Elektronik për Kompjuter është i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar në biznese, të cilat ofrojnë servis për kompjutera apo në institucione që kanë në përdorim kompjutera në infrastrukturën e tyre.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, riparuesi elektronik për kompjuter duhet të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me përdorimin e software-ve, njohjen dhe përdorimin e procedurave riparuese dhe të mirëmbajtjes, konceptet e procedurat bazë, si dhe **shprehi** profesionale që lidhen me veprimtarinë e riparuesit elektronik për kompjuter.

Suksesi i riparuesit elektronik për kompjuter është i lidhur ngushtë edhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: shkathtësia, qetësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e riparuesit Elektronik për kompjuter.

Profesioni i riparuesit elektronik për kompjuter është i lidhur ngushtë me procedurat e punës në identifikimin dhe riparimin e defekteve të hardware/software në sistemin kompjuterik si dhe instalime të komponenteve hardware/software në kompjuter. Ai mund të punësohet në servise kompjuteri, biznese apo institucione, të cilat e kërkojnë këtë shërbim.

Një individ mund të ushtrojë veprimtarinë e riparuesit elektronik për kompjuter fillimisht si ndihmës në kryerjen e shërbimeve të Riparuesit Elektronik për Kompjuter. Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivele më të kualifikuara. Nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një riparues elektronik për kompjutera mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si menaxher i një biznesi në profilin e Riparuesit Elektronik për Kompjuter.

Për të zhvilluar aktivitet privat në këtë sektor, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Riparues Elektronik për Kompjuter”, me kod 7422.11, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të kursit “Riparuesit Elektronik për Kompjuter”

Në përfundim të kursit për “Riparuesit Elektronik për Kompjuter”, kursantët do të jenë të aftë të:

- kryejnë mirëmbajtjen dhe riparimin e kompjuterit;
- kryejnë vlerësimin e përshtatshmërisë të sistemeve të ndryshme kompjuterike për aplikacione të ndryshme;
- kryejnë evidentimin dhe riparimin e defekteve të hardware-ve në sistemin kompjuterik të PC;

- kryejnë evidentimin dhe riparimin e defekteve të software-ve në sistemin kompjuterik të PC;
- kryejnë instalimin e komponenteve hardware në kompjuter;
- kryejnë instalimin e komponenteve software në kompjuter;
- kryejnë identifikimin dhe riparimin e defektet të motherboard-it;
- kryejnë matje elektrike dhe riparimin e defekteve elektronik;
- kryejnë riparimin e hardware-ve kryesore;
- kryejnë riparimin e hardware-ve periferike;
- kryejnë riparimin e memorjeve të ndryshme të kompjuterit;
- kryejnë formatimin e sistemeve të ndryshme operative dhe aplikacioneve bazë;
- përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin e riparuesit elektronik për kompjuter;
- zbatojnë legjislacionin dhe kodin e punës;
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik në mjedisin e punës;
- komunikojnë me etikë profesionale.

III. Kërkesat e pranimit në kursin për “Riparues Elektronik për Kompjuter,,

Pjesëmarrësit në kursin për “Riparues Elektronik për Kompjuter” duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të kenë njohuri bazë për përdorimin e kompjuterit.

IV. Kohëzgjatja e kursit për “Riparues Elektronik për Kompjuter“

280 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Riparues Elektronik për Kompjuter“

Nr.	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1.	Hyrje në profesionin e riparuesit elektronik për kompjuter.	REK-01-2022	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të Riparuesit Elektronik për Kompjuter. 2. Kursanti përshkruan komponentët kryesore të hardware dhe software. 3. Kursant zmonton dhe monton kompjuterin. 4. Kursanti mirëmban kompjuterin.
2.	Konfigurime në hardware dhe software.	REK-02-2022	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan komponentët fizik të kompjuterit. 2. Kursanti konfiguron Software. 3. Kursanti instalon pjesët Hardware. 4. Kursanti bën riparimin e procesorëve të ndryshëm. 5. Kursanti riparon monitorët.

3	Riparimi i pjesëve sekondare te kompjuterit.	REK-03-2022	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen diagnostifikimin e defekteve në Laptop. 2. Kursanti kryen testime dhe matje të paisjeve fizike. 3. Kursanti riparon defektet kompjuterike.
4.	Krijimi i një rrjeti lan.	REK-04-2022	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti krijon një sallë interneti. 2. Kursanti kryen konfigurime të ruterave dhe swicave. 3. Kursanti instalon servera të ndryshëm.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi.

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për Riparues Elektronik për Kompjuter:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e Riparuesit Elektronik për Kompjuter”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E RIPARUESIT ELEKTRONIK PËR KOMPJUTER.	REK-01-2022
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që njeh kursantët me komponentët kryesore të kompjuterit, me hardware, software, komponentët fizik, i aftëson ata në zmontimin dhe montimin e kompjuterit si dhe me rregullat e komunikimit dhe sigurisë në punë.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të kenë njohuri bazë për përdorimin e kompjuterit.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të Riparuesit Elektronik për Kompjuter. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:	

-
- të argumentojë qëllimin, rëndësinë shërbimeve të riparuesit elektronik për kompjuter;
 - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës;
 - të përshkruajë mjedisin, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës;
 - të përshkruajë proceset bazë të veprimtarisë së riparuesit elektronik për kompjuter;
 - të përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin e riparuesit elektronik për kompjuter;
 - të përshkruajë kërkesat për liçensim për ushtrimin e veprimtarisë së riparuesit elektronik për kompjuter;
 - të zbatojë legjislacionin e punës;
 - të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik në mjedisin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 2 Kursanti përshkruan komponentët kryesore të hardware dhe software ;

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë komponent të ndryshëm të hardware;
- të përshkruajë komponent të ndryshëm të software;
- të përshkruajë sistemin e operimit ;
- të përshkruajë programet e testimit;
- të përshkruajë programet për testim dhe punim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti zmonton dhe monton kompjuterin.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë pjesët përbërëse të kompjuterit;
- të përshkruajë pjesët periferike në sistemin kompjuterik (mouse, printer, modem).
- të përshkruajë procedurën e montimit dhe zmontimit të kompjuterit;
- të kryejë dallimin midis llojeve të ndryshme të PC si XT;
- të kryejë identifikimin dhe heqjen e pjesëve specifike nga kompjuteri AT, 386, 486, Pentium etje;

- të kryejë zmontimin dhe montimin e pjesëve periferike në sistemin kompjuterik (mouse, printer, modem);
- të kryejë instalimin e komponentëve kryesore;
- të kryejë instalimin e software bazuar manualeve;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik në mjedisin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë- me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti mirëmban kompjuterin.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet e defekteve;
- të përcaktojë llojet e defekteve;
- të përshkruajë mirëmbajtjen rutinë dhe preventive;
- të kryejë mirëmbajtjen rutinë dhe preventive të kompjuterit;
- të përshkruajë defektet e zakonshme të hard diskut;
- virusin, baterinë e motherboard, si dhe errorret e zakonshëm etj;
- të riparojë dhe mirëmbajë hard diskun;
- të riparojë baterinë e motherboard;
- të instalojë antiviruset dhe të riparojë errorret e zakonshme, etj,
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik në mjedisin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'u jepen detyra: të përshkruajnë veçoritë e profesionit të riparuesit elektronik për kompjuter.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

realizimin e modulit	- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës. - Kompleti i materialeve, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për riparuesin elektronik për kompjuter. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-----------------------------	--

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Riparues Elektronik për Kompjuter”

2. Moduli “Konfigurimet në hardware dhe software”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KONFIGURIME NË HARDWARE DHE SOFTWARE	REK-02-2022
Qëllimi i modulit	Një modul praktik i cili i aftëson kursantët për kryerjen e konfigurimit të software, instalimin e pjesëve hardware si dhe riparimin e procesorëve të ndryshëm, monitorëve duke respektuar rregullat e komunikimit dhe sigurisë në punë.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të kenë njohuri bazë për përdorimin e kompjuterit, si dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e riparuesit elektronik për kompjuter”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan komponentët fizik të kompjuterit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë komponentet fizikë; - të përshkruajë kasat e njësive qendrore; - të dallojë ndryshimin mes kasave dhe përshtatshmërinë; - të përshkruajë software; - të përshkruajë hardware; - të përshkruajë ndërtimin e procesorëve të ndryshëm. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Pyetje - përgjigje me shkrim.	

RM 2 Kursanti konfiguron software.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë karakteristikat e Bios;
- të përshkruajë funksionin që kryen bios;
- të përshkruajë llojet e defekteve në software;
- të identifikojë defektet në software;
- të riparojë defektet në software;
- të realizojë konfigurimin me mënyra të ndryshme;
- të kryejë përzgjedhjen e BOOT dhe BOOT sequence;
- të kryejë përzgjedhjen e BOOT menu;
- të shmangë problemet që hasen nga konfigurimi i keq;
- të kryejë kontrollin software-ik;
- të realizojë konfigurimin e saktë të software.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë-shkrim.
- Vëzhgim me list kontrolli.

RM3 Kursanti instalon pjesët Hardware.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë ndërtimin e motherboard dhe chipset;
- të identifikojë kartën grafike;
- të përshkruajë memorjet e ndryshme HDD, FDD, Flash driver (USB), CD, DVD, Bio-RAY, online ose cloud storage.
- të përshkruajë llojet e HDD;
- të kryejë kontrollin e hardware;
- të identifikojë defektet e mundshme në HDD;
- të kryejë riparimin e defekteve të ndryshme në HDD;
- të kryejë instalimin e një HDD të ri;
- të realizojë shtimin e një HDD për memorje shtesë;
- të përshkruajë funksionet e CD dhe DVD, ROM, RW, punën që kryen, dhe llojet;
- të identifikojë defekte të ndryshme dhe kryejë riparimin e tyre;
- të kryejë update të bios;
- të kryejë update të Ps;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë- me shkrim.

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti bën riparimin e procesorëve të ndryshëm.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë CPU, sockët e ndryshme;
- të diagnostifikojë defektet të ndryshme;
- të kryejë riparime të defekteve;
- të identifikojë defektet e mundshme që jep procesori;
- të riparojë defektet e mundshme të procesorit;
- të kryejë ndarjen dhe përzgjedhjen e procesorëve në bazë të punës .
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me list kontrolli.

RM 5 Kursanti riparon monitorët.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë monitorët, ekranet (CCD LED) dhe funksionimi i tyre;
- të përshkruajë ndërtimin e një ekrani të Laptopit (CCD LED);
- të identifikojë defektet e ndryshme;
- të riparojë defektet në monitor,
- të kryejë zëvendësimin e ekranit;
- të kryejë riparimin dhe zëvendësimin e Power supply, (Blloqet e ushqimit);
- të identifikojë modele të ndryshme, mënyrat e funksionimit dhe kapacitetet e tyre;
- të kryejë përzgjedhjen e fuqisë në bazë të nevojave të kompjuterit;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me list kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në kabinet. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'u jepen detyra: të bëjnë riparimin e një procesori. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës. - Komplet i materialeve, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për riparuesin elektronik për kompjutera si dhe paisje te ndryshme si: kompjutera, pjesë hardware, pjesë periferike , skaner, printer, modema të ndryshëm etj. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Riparues Elektronik për Kompjuter”

3. Moduli “Riparimi i pjesëve sekondare të kompjuterit ”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	RIPARIMI I PJESËVE SEKONDARE TË KOMPJUTERIT.	REK-03-2022
Qëllimi i modulit	Një modul praktikë që aftëson kursantët për diagnostifikimet e defekteve kompjuterike dhe riparimin e pjesëve sekondare të kompjuttrit/laptopit, testimet e paisjeve fizike, si dhe me zbatimin e rregullave të komunikimit dhe sigurisë në punë.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të kenë njohuri bazë për përdorimin e kompjuterit, si dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e riparuesit elektronik për kompjuter” dhe “Konfigurime në hardware dhe software”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti kryen diagnostifikimin e defekteve në Laptop. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë ndërtimin e pjesëve përbërëse të Laptopit, dhe funksionin e tyre; - të kryejë përzgjedhjen e projektorëve në bazë të modeleve, foleve dhe moshave; - të identifikojë problemet që hasen me laptopin dhe pjesët e tjera portative; - të kryejë mirëmbajtjen e laptopit; - të identifikojë pjesët zëvendësuese dhe jo të zëvendësueshme; - të kryejë zëvendësimin e RAM dhe NDD; - të kryejë zëvendësimin e Wireless card touch pad bluetooth i modemit të brendshëm; - të kryejë zëvendësimin e qarqeve elektrike të Laptopit; - të kryejë riparimin dhe zëvendësimin e memorjes së lëvizshme; - të riparojë defekte të ndryshme; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje me gojë me shkrim. - Vëzhgim me listë kontrolli.	

RM 2 Kursanti kryen testime dhe matje të paisjeve fizike.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë mënyrat e testimeve të paisjeve fizike;
- të përshkruajë mënyrat e matjeve të testimeve të paisjeve fizike;
- të diagnostifikojë defekte të ndryshme në paisjet fizike;
- të kryejë riparimin e hardware në sistemin e kompjuterave;
- të kryejë riparimin e kompjuterit;
- të zëvendësojë e riparojë kartën e diagnostifikimit;
- të riparojë sistemet e diagnostifikimit;
- të riparojë aparaturat matëse të elementëve (Multimeter);
- të kryejë instalimin e hardware-ve në kompjuter;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë-shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti riparon defektet kompjuterike.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë defektet e mundshme;
- të përshkruajë frekuencën e memories RAM;
- të përshkruajë kapacitetin e memories RAM;
- të diagnostifikojë defekte të ndryshme;
- të riparojë sistemin Video;
- të kryejë ndërrimin e kartës grafike;
- të kryejë ndërrimin e memories RAM;
- të kryejë riparimin e komponentëve të kompjuterit, CPU, kartë grafike;
- të kryejë riparimin e sistemit të degustimit audio;
- të kryejë riparimin e kartës së zërit, mikrofonët, bokset, aplikacionet e zërit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë me shkrim .
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'u jepen detyra: kryen testime dhe matje të paisjeve fizike ose të kryejnë riparime të defekteve të ndryshme kompjuterike. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës. - Komplet i materialeve, pajisjeve dhe instrumenteve të punës si dhe kompjutera, laptope, pjesë hardware, pjesë periferike katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Riparues Elektronik për Kompjuter”

4. Moduli “Krijimi i një rrjeti lan ”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KRIJIMI I NJË RRJETI LAN.	REK-04-2022
Qëllimi i modulit	Një modul praktikë që aftëson kursantët me instalimet e programeve Software, krijimin e një sallë interneti, konfigurime të ruterave, switch, instalimin e serverave të ndryshëm, me diagnostifikimin dhe riparimin e defekteve duke zbatuar rregullat e komunikimit dhe sigurisë në punë.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të kenë njohuri bazë për përdorimin e kompjuterit si dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e riparuesit elektronik për kompjuter”, “Konfigurime në hardware dhe software” dhe “Riparimi i pjesëve sekondare të Kompjuterit”.	

**Rezultatet e të
mësuarit (RM)
dhe procedurat
e vlerësimit**

RM 1 Kursanti krijon një sallë interneti.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë krijimin e një sallë interneti;
- të kryejë hyrjen në net working;
- të instalojë sistemet operative PC-Laptop;
- të konfigurojë Programet MS office;
- të konfigurojë programet lan mine, dhe wireless;
- të demonstrojë ndërtimin e llojeve të ndryshme të rrjeteve dhe vënia në funksion e tyre;
- të kryejë lidhjen e kompjuterave në rrjet;
- të diagnostifikojë defekte të ndryshme të sistemit të operimit windos;
- të kryejë riparime në sistemin e operimit windos;
- të identifikojë lloje të ndryshme të modemave;
- të diagnostifikojë dhe të riparojë difektete ndryshëm në modema;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në mjedisin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë- shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti kryen konfigurime të ruterave dhe swichave.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rutera të ndryshëm;
- të kryejë konfigurime të ruterave të ndryshëm;
- të përshkruajë swiche të ndryshëm;
- të kryejë konfigurime të swich-eve të menaxhueshëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në mjedisin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë- shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti instalon servera të ndryshëm.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë lloje serverash të ndryshëm;
- të insatalë modele të ndryshëm serverash;
- të konfigurojë role të ndryshëm në servera;

- të konfigurojë serverin në varësi të nevojës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në mjedisin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë- shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'u jepen detyra: të konfigurojnë servera në varesi të nevojës. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës.
 - Komplet i materialeve, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për riparuesin elektronik per kompjutera. Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-